



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike, nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2022, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR VENDOSJEN E BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË QYLAGË –FAZA E PARË

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtari i Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qylagë –faza e parë, Ferdian Shala në numrin rendor 5, nga shoqëria civile, i emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.330/01-28079 të datës 31.05.2022 për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qylagë –faza e parë sipas kërkesës së tij për dorëheqje dhe në vend të tij caktohet **Bekim Krasniqi** poashtu nga shoqëria civile i përzgjedhur përmes ftesës publike për aplikim.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "parku industrial" në Qylagë –faza e parë 15Nr.330/01-28079 të datës 31.05.2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Lipjanit, Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Zëvendësimi i anëtarit të lartëcekur bëhet duke u bazuar në kërkesën së tij për dorëheqje pasi nuk mund të jetë përfaqësues nga Shoqëria Civile përshkak të punësimit të tij në kuadër të Shërbimit Civil të Administratës Komunale të Lipjanit.

Nga të cekurat kërkojmë nga Kuvendi Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/01-56293
Lipjan, 14.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

